

FORMULARI I NJOFTIMIT TE FITUESIT

Ujësjetllës Kanalizime Durrës Sh.a

Durrës, 14/08/2019

“Sistemimi i kanalizimeve të ujrave të ndotura të zonës Turistike Hamallaj, Faza I, Njësia Adm.Sukth, Bashkia Durrës”

Për: “2T” nipt **K01731001M**, me adresë: Rruga Asim Vokshi, Tirane.

Procedura e prokurimit: “Procedurë e hapur-pune”

Numri i references se procedures/lotit: . – **23769-05-27-2019**

Përshkrim i shkurtër i kontratës:

Objekti: **“Sistemimi i kanalizimeve të ujrave të ndotura të zonës Turistike Hamallaj, Faza I, Njësia Adm.Sukth, Bashkia Durrës”**

- Fondi limit: **82,111,600.45** (Tetëdhjetë e dy milion e njëqind njëmbëdhjetë mijë e gjashtëqind presje dyzet e pese) lekë pa TVSH
- Burimi i te ardhurave: Te ardhurat e U.K.D Sh.a
- Kohezgjatja e kontrates: **120 ditë kalendarike duke filluar nga dita e nesërme e punes pas nënshkrimit të kontrates sipas grafikut të punimeve të hartuar nga projektuesi.**
- Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: çmimi më i ulët

Njoftojmë se, kanë qënë pjesëmarrës në procedurë 5(pese) Operatorë Ekonomik si me poshte:

1. **Bashkimi i operatoreve “B-93”, me nipt J62903508R, “SHENDELLI”, me nipt K07924803N dhe “METEO”, me nipt L26310801C me vlere te ofruar:**
 - **pa TVSH është 69’477’050 (gjashtëdhjetë e nente milion e katerqind e shtatëdhjetë e shtate mijë e pesëdhjetë) lekë.**
 - **me TVSH është 83’372’460 (tetëdhjetë e tre milion e treqind e shtatëdhjetë e dy mijë e katerqind e gjashtëdhjetë) lekë.**
2. **“FUSHA”, me nipt J61922018S, me vlere te ofruar:**
 - **pa TVSH është 75’497’815,5 (shtatëdhjetë e pese milion e katerqind e nentëdhjetë e shtate mijë e teteqind e pesëmbëdhjetë presje pese) lekë.**

- me TVSH është 90'597'378,6 (nentedhjetë milion e pesëqind e nentedhjetë e shtatë mijë e treqind e shtatedhjetë e tete presje gjashtë) lekë.

3. Bashkimi i operatoreve “LALA” me nipt J76418903B dhe “Arifaj” me nipt J76418907K, me vlere te ofruar:

- pa TVSH është 77'716'046,16 (shtatedhjetë e shtatë milion e shtateqind e gjashtembedhjetë mijë e gjashtembedhjetë) lekë.
- me TVSH është 93'259'255,39 (nentedhjetë e tre milion e dyqind e pesedhjetë e nente mijë e dyqind e pesedhjetë e pese presje nentedhjetë e nente) lekë.

4. 2T, me nipt K01731001M, me vlere te ofruar:

- pa TVSH është 79'915'686,35 (shtatedhjetë e nente milion e nenteqind e pesembedhjetë mijë e gjashteqind e tetedhjetë e gjashtë presje tridhjetë e pese) lekë.
- me TVSH është 95'898'823,62 (nentedhjetë e pese milion e teteqind e nentedhjetë e tete mijë e teteqind e njezet e tre presje gjashtë e dy) lekë.

5. BE-IS, me nipt K71412003A, me vlere te ofruar:

- pa TVSH është 81'567'667,6 (tetedhjetë e një milion e pesëqind e gjashtedhjetë e shtatë mijë e gjashteqind e gjashtedhjetë e shtatë presje gjashtë) lekë.
- me TVSH është 97'881'213,12 (nentedhjetë e shtatë milion e teteqind e tetedhjetë e një mijë e dyqind e trembedhjetë presje dymbedhjetë) lekë.

Jane skualifikuar operatorët ekonomik si me poshte:

- Bashkimi i Operatoreve ekonomik “B-93”, “SHENDELLI” dhe “METEO” është skualifikuar për arsye se nuk përmbush:
1. Kriteret e vecanta te kualifikimit/ pasi: oferta ekonomike nuk ka të përfshirë fondin rezervë prej 3%, kjo në kundërshtim me fletën përmbledhëse të preventivit të ngarkuar në DST;
 2. Kapacitetin Teknik pika 4/ pasi;
Operatori B-93 nuk përmbush numrin e punonjësve me kohë të plotë, pasi nga 76 që duhet sipas % së bashkëpunimit ka deklaruar mesatarish rreth 46 punonjës.
Operatori Shëndëlli nuk përmbush numrin e punonjësve me kohë të plotë, pasi nga 65 që

duhet sipas % së bashkëpunimit ka deklaruar mesatarisht rreth 47 punonjës.

3. Kapacitetin Teknik pika 4.1 dhe 4.2/ pasi;
Operatori Meteo: drejtuesja teknike nuk përmbush min 10 vite punë dhe ing.Hidroteknik nuk e ka të deklaruar në Listëpagesat e shoqërisë për 6-muaj.
Operatori Shendelli: punonjës in Ing.Mjedisi nuk e ka të deklaruar nuk e ka të deklaruar në Listëpagesat e shoqërisë për 6-muaj.
Bashkimi i Operatorëve ekonomik nuk ka staf të kompanisë: 2 Ing. Ndërtimi, 1 Ing.Topograf, që nuk janë drejtues teknik.
4. Kapacitetin Teknik pika 4.4/ pasi;
Bashkimi i Operatorëve ekonomik nuk ka staf specialiste të kualifikuar: 2 teknik mekanik, 2 elektromekanik, 2 buldozerist
Bashkimi i Operatorëve ekonomik stafin me specialistë të kualifikuar, nuk e ka të deklaruar në listëpagesë sipas periudhës së kërkuar.
5. Kapacitetin Teknik pika 6/ pasi: bashkimi i operatoreve ekonomik nuk ka paraqitur makineritë dhe pajisjet: mjet kulle, pajisje Well Point, makineri për nxjerrje kollonash, cekic vibrues, palankola. Pajisja sonde shpimi nuk përmbush kriteret teknike të kërkuara dhe nuk ka foto.
Kontrata e furnizimit Beton Vlore dhe Lushaku me B-93, nuk janë të deklaruar në shtojcë sipas nr. të kontratave. **Impianti i betonit** me vendodhje në Vlorë dhe Lushje, distancë teknikisht e papranueshme nga objekti.
Sipas % të zërave të punimeve që BO ka marrë përsipër të kryejë, kontrata e furnizimit me beton duhet të ishte me operatorin Shëndëlli, dhe jo me B-93.
6. Kapacitetin Teknik pika 7/ pasi: sipas % të zërave të punimeve që BO ka marrë përsipër të kryejë, nuk kanë paraqitur autorizim dhe kontratë furnizimi për pusetat plastike dhe rakordritë sipas pikës 4 në preventiv.
7. Kapacitetin Teknik pika 8/ pasi: nuk ka sjelle analiza për të gjithë zerrat kryesor të preventivit.

- Operatori ekonomik **“FUSHA”** është skualifikuar për arsye se nuk përmbush:

1. Kapacitetin Teknik pika 2/ pasi; nuk përmbush kategorinë NP.6-B të lincensimit.
2. Kapacitetin Teknik pika 4.4/ pasi; ka paraqitur 2 mekanik, nga 4 të kërkuar.
3. Kapacitetin Teknik pika 6/ pasi: nuk ka paraqitur pajisje Eell point sipas specifikimeve të kërkuara por një pompë uji shumë stadesh. Nuk ka paraqitur palankola.

- Bashkimi i Operatoreve ekonomik **“LALA”** dhe **“ARIFAJ”** është skualifikuar për arsye se nuk përmbush:

1. Kapacitetin Teknik pika 1/ pasi; OE Afifaj nuk ka punë të ngjashme sipas objektit të prokurimit.
2. Kapacitetin Teknik pika 2/ pasi; bashkimi i OE nuk përmbush kategorinë NP.6-B të lincensimit.
3. Kapacitetin Teknik pika 3/ pasi; OE Arifaj nuk ka paraqitur certifikate ISO SA8000:2014
4. Kapacitetin Teknik pika 4/ pasi;

Operatori Lala nuk përmbush numrin e punonjësve me kohë të plotë, pasi nga 51 që duhet sipas % së bashkëpunimit ka deklaruar mesatarish rreth 49 punonjës.

5. Kapacitetin Teknik pika 4.1 dhe 4.2/ pasi;

Operatori Arifaj: drejtuesja teknike nuk përmbush min 10 vite punë.

Bashkimi i Operatorëve ekonomik nuk ka staf të kompanisë: 2 Ing. Ndërtimi, 1

Ing. Topograf, që nuk janë drejtues teknik

6. Kapacitetin Teknik pika 4.4/ pasi;

Bashkimi i Operatorëve ekonomik nuk ka staf specialiste të kualifikuar: 2 teknik mekanik, 1 punëtor izolimi. Kane paraqitur: 2 mekanik, nga 4 të kërkuar; 1 elektromekanik nga 2 të kërkuar;

Bashkimi i Operatorëve ekonomik stafin me specialistë të kualifikuar, nuk e ka të deklaruar në listëpagesë sipas periudhës së kërkuar.

7. Kapacitetin Teknik pika 6/ pasi: bashkimi i operatoreve ekonomik nuk ka paraqitur makineritë dhe pajisjet: nivelues betoni helicopter, rule gome hekur 5 ton, mjet kulle, vinc karrel, pajisje Well Point, makineri për nxjerrje kollonash, çekic vibruës, palankola. **Impianit i betonit** me vendodhje në Krujë, distancë teknikisht e papranueshme nga objekti.

- Operatori ekonomik **“BE-IS”** është skualifikuar për arsye se nuk përmbush:

1. Kapacitetin Teknik pika 4/ pasi; nuk përmbush numrin e punonjësve me kohë të plotë.
2. Kapacitetin Teknik pika 4.1 dhe 4.2/ pasi; drejtuesja teknike është inxhinieri mjedisi dhe jo hidroteknik/ndërtimi. Nuk ka staf të kompanisë: 1 Ing. Topograf, që nuk është drejtues teknik.
3. Kapacitetin Teknik pika 4.4/ pasi; nuk ka staf specialiste të kualifikuar: 2 teknik mekanik, 2 buldozerist. Ka paraqitur: 1 mekanik, nga 4 të kërkuar; 2 murator nga 4 të kërkuar.
4. Kapacitetin Teknik pika 6/ pasi: nuk ka paraqitur eskavator me goma, eskavator kap 30-40, eskavator me krahe të gjatë, minifadrome, rimorkiator, kamioncina, nivelues betoni, impiant Betoni, mjet kulle, pajisje Well Point, makineri për nxjerrje kollonash, çekic vibruës, palankola. Sonda e paraqitur nuk përmbush specifikimet e kërkuara. Pajisjet e paraqitura depozite uji, pompe uji dhe gjeneratore, nuk i ka të deklaruar në shtojcën e makinerive.
5. Kapacitetin Teknik pika 7, 8, pasi: nuk ka paraqitur kontate furnizimi për materiet, analiza për zërat kryesore në ofertë.

Pra kualifikohet Operatori Ekonomik **“2T” sh.p.k**, me vlerë të ofruar:

Duke ju referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë **“2T” sh.p.k** se oferta e paraqitur,

me nje vlere te pergjithshme prej: **pa TVSH është 79'915'686,35 (shtatedhjetë e nente milion e nenteqind e pesëmbëdhjetë mijë e gjashtëqind e tetëdhjetë e gjashtë presje tridhjetë e pesë) lekë dhe me TVSH është 95'898'823,62 (nëntëdhjetë e pesë milion e tetëqind e nëntëdhjetë e tetë mijë e tetëqind e njëzet e tre presje gjashtë e dy) lekë është identifikuar si oferta e suksesshme.**

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë Ujesjelles Kanalizime Durrës sh.a sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda 30 ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Njoftimi i klasifikimit është bërë në datë: **15/07/2019**

Gjatë afatit ligjor prej 7 ditësh për pritjen e ankesave pati ankesë nga Bashkimi i operatoreve “**LALA**” dhe “**ARIFAJ**” me date 22/07/2019, me date 29/07/2019 u bë shqyrtim i ankesës, e cila nuk u mor parasysh nga Grupi i shqyrtimit të ankesës dhe ju dergua me postë operatorit, i cili mori dijeni sipas dates se vendosur në lajmerim marrje me date 31/07/2019.

Gjatë afatit 10 ditor për ankesë në KPP nuk pati ankesë.

**ADMINISTRATOR
ING.SPARTAK KOVAÇI
PERSONI I AUTORIZUAR
Z. KASEM BEJKO**